

10.04.2014 – Në lidhje me këstet e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin

Bazuar në **Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, çdo subjekt që kryen një qarkullim vjetor deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Për t’u pajisur me urdhërpagesat e kësteve të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin çdo tatimpagues pasi të log-ohet në llogarinë e tij të deklarimit elektronik, duhet të klikojë në nyjen **Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin – Këstet e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin**. Urdhërpagesat e këstit përkatës të tatimit mbi Fitimin e Thjeshtuar, duhet të printohen në 2 kopje dhe të paraqiten **për pagesë në një prej bankave të nivelit të dytë** për llogari të Administratës Tatimore Qëndrore.

Për subjektet që realizojnë të ardhura 2-8 milion leke, afati i pagesës së këstit të parë të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin është data 20 Prill 2014. Ndërsa për subjektet me qarkullim 0-2 milion lekë afati i pagesës së Tatimit fiks vjetor 25.000 lekë është data 30 Qershor 2014.

Pas konfirmimit bankar të pagesës, tatimpaguesi dorëzon, në Zyrën e Shërbimit për tatimpaguesit në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, një kopje të urdhërpagesës së bashku me një kopje të dokumentit bankar që vërteton pagesën. Kundrejt paraqitjes së këtyre dokumentave, tatimpaguesi merr “Pullën e Tatimit” të këstit për të cilin ka bërë pagesën.

Duke klikuar në Legjislacioni tatimor në fuqi – Sistemi i taksave vendore, të www.tatime.gov.al, ju mund njiheni me përmbajtjen e plotë të Ligjeve të përditësuara si dhe akteve nënligjore.

Për çdo pyetje apo informacion ju mund të kontaktoni me Drejtoritë apo Sektorët e Shërbimit ndaj tatimpaguesve në të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Specialistët e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve do të jenë në shërbimin tuaj.

Administrata Tatimore ju mirëpret!!